



K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A., Rr. Wesley Clark,
Pn. 20000, në Prizren

Në bazë të Nenit 7, pika 2 të Statutit të K.R.U."Hidroregjioni Jugor"Sh.A., me datë 27.07.2012,
Bordi i Drejtorëve të K.R.U."Hidroregjioni Jugor"Sh.A., me seli në Prizren, aprovoi këtë

RREGULLORE MBI PROCEDURAT E THEMELIMIT TË MARËDHËNJES SË PUNËS NË K.R.U. "HIDROREGJIONI JUGOR"Sh.A. NË PRIZREN

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurat themelimit të marëdhënjes së punës në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor",Sh.A. (në tekstin e mëtejshëm Kompania) në Prizren në pajtim me Ligjin e Punës nr. 03/L-212, datë: 01.11.2010 (në tekstin e mëtejshëm Ligji), Kontratën e Përgjithshme Kolektive, Kontratës së Punës, Aktet tjera të brendshme të Kompanisë si dhe Ligjet tjera të cilat i rregullojnë marëdhënjet në këtë lëmi.

Neni 2

Hierarkia në mes të Ligjit, Statutit dhe kësaj Rregulloreje

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit, Statutit të Kompanisë, Kontratës Kolektive, Akteve të Brendshme të Kompanisë dhe Kontratës së Punës.
2. Në rast konflikti ndërmjet Ligjeve, Statutit të Kompanisë, Kontratës Kolektive, Akteve të Brendshme të Kompanisë dhe Kontratës së Punës me këtë Rregullore, atëherë, dispozitat përkatëse të kësaj Rregulloreje konsiderohen të revokuara ose të ndryshuara në masën e nevojshme për eliminimin e mospërputhjes.
3. Kjo Rregullore mund të përmbajë dispozita me të cilat përcaktohen më shumë të drejta dhe kushte të favorshme, nga të drejtat dhe kushtet e përcaktuara me Ligj, përveç nëse me Ligj është përcaktuar ndryshe.

Neni 3

Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit

Dispozitat e Ligjit nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit, do të zbatohen drejtpërsëdrejti kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të punonjësit dhe Kompanisë.

Neni 4

Ndalimi i punës së detyruar ose të dhunshme

1. Puna e detyruar ose e dhunshme është e ndaluar.
2. Përjashtimisht punë e detyruar nuk konsiderohet puna ose shërbimi të cilin e kryejnë punonjësit në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, të shpallur sipas nenit 131 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Neni 5

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregullore vlejnë dhe zbatohen për punësimin e punonjësve në Kompani. Departamenti i Administratës së Kompanisë është përgjegjës për zbatimin e procesit të themelimit të marrëdhënies së punës.

Neni 6

Kushtet dhe kriteret për punësim të punonjësve

1. Marrëdhënia e punës mund të themelohet me çdo person prej moshës tetëmbëdhjetë (18) vjeç.
2. Marrëdhënia e punës mund të themelohet edhe me personat në mes të moshës pesëmbëdhjetë (15) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç, të cilët mund të punësohen për punë të lehta që nuk paraqesin rrezik për shëndetin ose zhvillimin e tyre dhe nëse ajo punë nuk është e ndaluar me ndonjë ligj ose akt nënligjor.
3. Në Kompani ndalohet të lidhet kontratë pune me personat nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.

Neni 7

Punësimi jashtë Kompanisë

1. Punëtorët nuk janë të përkrahur për të mbajtur punën e dytë jashtë Kompanisë, dhe ndalohet punësimi i punonjësve të Kompanisë jashtë sajë, nëse ky punësim paraqet konflikt të interesit.
2. Nëse një punëtor dëshiron të mbajë një punë jashtë Kompanisë, ai duhet të aplikojë në pajtim me kushtet që do ti parashtrojë Kompania, si dhe me aprovim nga mbikëqyrësi i tij dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
3. Nëse nga Kompania konstatohet se puna e punëtorit jashtë Kompanisë ndikon në performancë apo mundësinë për të përmbushur kërkesat e Kompanisë, nga i punësuari do të kërkohet të përfundojë kontratën jashtë Kompanisë nëse dëshiron që ai të mbetet në Kompani.

Neni 8

Pagesa e kontributeve

Për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore, Kompania e merr për detyrë që të punësuarin t'a lajmërojë në Administratën Tatimore të Kosovës, institucionet e tjera të cilat i menaxhojnë dhe administrojnë skemat e obligueshme pensionale dhe skemat e tjera të obligueshme.

Neni 9

Arsyet për punësim të punonjësve të rinj

Kompania bënë punësimin e punonjësve të rinjë në rastet kur paraqitet kërkesa për:

- Plotësim të pozitës së lirë;
- Arësye të shtimit të volumit të punëve gjë e cila kërkon staf shtesë, si dhe
- Vende të reja të punës të cilat nuk kanë ekzistuar deri më tani.

Neni 10

Puna provuese

1. Puna provuese përcaktohet me Kontratën e Punës.
2. Puna Provuese mund të zgjasë, më së shumti gjashtë (6) muaj sipas kushteve të parapara me Ligj, Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Kompanisë.
3. Gjatë periudhës provuese të punës marrëdhënja e punës mundë të ndërpritet me njoftim paraprak prej shtatë (7) ditësh qoftë nga punonjësi apo Kompania si punëdhënëse.

Neni 11

Praktikantët

1. Kompania mund të lidhë Kontratë Pune me praktikantin i cili i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës sikurse të punësuarit e tjerë.
2. Puna praktike e praktikantit me përgatitje pasuniversitare, universitare dhe të lartë mund të zgjasë më së shumti një (1) vit, ndërsa puna praktike e praktikantit me shkollim të mesëm mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj.
3. Kompania si punëdhënëse në marrëveshje me personin e interesuar mundet që të njëjtin ta angazhojë praktikant pa ndonjë kompensim të pagës dhe të drejtave të tjera nga marrëdhënia e punës, mirëpo duhet të ofrojë mbrojtje dhe siguri në vendin e punës sipas ligjit, gjithashtu Kompania ka për detyrë që ta evidentojë praktikantin në listën e evidencave të punonjësve pa kompensim page.

Neni 12

Shpallja e vendit të lirë të punës

1. Shpallja e vendit të lirë të punës bëhet nga Departamenti i Administratës së Kompanisë.
2. Për plotësimin e vendit të lirë të punës, Departamenti i Administratës së Kompanisë ka të drejtë që pa shpallur Konkurs Publik të cakton punëtorin i cili është duke kryer punë dhe detyra të punës në këtë subjekt punues, nëse i njëjti i plotëson kushtet dhe kriteret e kërkuara për atë vend të punës.
3. Nëse për vendin e lirë të punës ka një ose më shumë kandidatë, atëherë Departamenti i Administratës duhet të shpallë Konkursin Publik për plotësimin e atij vendi të lirë të punës.
4. Konkursi duhet të përsëritet nëse së paku 3 (tre) kandidatë nuk i kanë plotësuar kriteret e Konkursit.

Neni 13

Themelimi i Komisionit për Zhvillimin e Procedurave për Themelimin e Marëdhënjes së Punës

1. KE apo i autorizuari i tij themelojnë Komisionin për Zhvillimin e Procedurave për Themelimin e Marëdhënjes së Punës.
2. Mandati i Komisionit, përfundon me përfundimin e procedurave të rekrutimit.
3. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, i cili duhet të jetë i ekuilibruar në kuptimin nacional, gjinorë dhe përfaqësim.
4. Së paku 3 (tre) anëtarë të Komisionit duhet të jenë në pozitë më të lartë se pozita që përzgjedhet me Konkurs, ndërsa dy anëtarë mundë të jenë në pozitë të barabartë.

Neni 14

Procedurat e përzgjedhjes së kandidatit

1. Përzgjedhëja e kandidatëve do të bëhet pasi të njëjtit do të testohen dhe intervistohen sipas kriterëve të Konkursit publik të shapllur.
2. Për fillimin e procedurave duhet të jenë së paku 3 (tri) aplikacione që i plotësojnë kushtet sipas konkursit.
3. Kandidatët e përzgjedhur në listën për intervistim duhet të njoftohen me shkrim apo rrugë tjetër të sigurtë, së paku 48 (dyzet e tetë) orë, para mbajtjes së testeve.

Neni 15

Testi me shkrim

1. Testi me shkrim duhet të jetë i njëjtë për të gjithë kandidatët dhe pyetjet duhet të jenë të formuluar qartë dhe saktë në pajtim me vendin e punës.

2. Testi përbëhet nga 3 (tri) pjesë:
 - 5.1. Pjesa e njohurive të përgjithëshme,
 - 5.2. Pjesa e pyetjeve të aftësive të përgjithëshme dhe personalitetit, dhe
 - 5.3. Pjesa me pyetjet që lidhen drejtpërsëdrejti me vendin e punës.
 3. Testi duhet ti ketë 100 poena:
 - 25 (njëzet e pesë) poena pjesa e parë;
 - 35 (tridhjetë e pesë) poena pjesa e dytë, dhe
 - 40 (dyzet) poena pjesa e tretë.
- Pyetjet duhet të jenë 50% me përgjigje të shumëfishta dhe 50% me përgjigje në formë të eseve.

Neni 16

Përgjigjet

1. Për çdo pyetje bëhen 2 (dy) përgjigje:
 - e saktë, dhe
 - e pasaktë, ndërsa për rastet kur 2 (dy) pyetjet janë të pasakta në pyetjen e shtruar, kandidati duhet të shkruaj me fjalë përgjigjen.
2. Për secilën pyetje duhet të jetë caktuar numri i pikëve të cilat do ti fitoj kandidati për përgjigjen e saktë.
3. Kandidatët të cilët kanë dhënë përgjigje të sakta në mbi 50% të pyetjeve të shtruara në test, duhet të ftohen në intervistim.
4. Nga Komisioni intervistues do të përzgjidhet kandidati i cili ka fituar numrin më të madh të totalit të pikëve në testin me shkrim dhe intervistim.

Neni 17

Afatet

1. Konkursi Publik duhet të jetë i shpallur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë në mjetet e informimit publik dhe ato elektronike, në web faqen e Kompanisë si dhe në tabelat informuese në hyrjet e të gjitha objekteve administrative të Kompanisë.
2. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas mbylljes së Konkursit, kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e Konkursit duhet të ftohen në testin me shkrim.
3. Kandidatët do të intervistohen brenda 10 (dhjetë) ditëve prej ditës së mbajtjes së testit me shkrim.
4. Konkursi duhet të përsëritet nëse së paku 3 (tre) kandidatë nuk i kanë plotësuar kriteret e Konkursit.
5. Afatet e përcaktuar në paragrafët 1, 2, dhe 3 të këtij Neni do të vlejnjë edhe në rastin shpalljes së Konkursit sipas Nenit 12 të kësaj Rregulloreje.

Neni 18

Shpallja e të përzgjedhurit

1. Departamenti i Administratës do ta shpallë në vend të dukshëm (në tabelën e shpalljeve të Kompanisë):

- Listën e kandidatëve konkurrues;
- Si dhe numrin e pikëve të fituara nga secili kandidat.

2. Departamenti i Administratës do ta informoi në afat prej 3 (tri) ditësh kandidatin e përzgjedhur.

Neni 19

Nënshkrimi i Kontratës së punës

1. Kandidati i përzgjedhur nga Neni paraparak duhet të nënshkruaj kontratën për themelimin e marrëdhënjes së punës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve prej ditës së informimit të përzgjedhjes së tij.

2. I punësuari e fillon punën ditën e përcaktuar me Kontratën e Punës.

3. Nëqoftëse i punësuari nuk e fillon punën në ditën e caktuar me Kontratën e Punës, do të konsiderohet se nuk ka themeluar marrëdhënie pune, përveq në qoftë se është penguar të fillojë punën për shkaqe të arsyeshme, ose në qoftë se punëdhënësi dhe i punësuari janë marrë vesh ndryshe.

Neni 20

Ankesa

1. Kandidatët e pakënaqur me përzgjedhjen e kanë të drejtën e Ankesës në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e shpalljes së të përzgjedhurit.

2. Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit për shqyrtimin e Ankesave mundë ti drejtohen Inspektorit të Punës në komunën përkatëse brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

3. Inspektori i Punës në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh do të nxjerrë vendim lidhur me ankesën nga paragrafi 2 (dy) i këtij neni.

Neni 21

Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të kësaj Rregullore e bënë Sekretari i Kompanisë në bashkëpunim me Zyrën Administrative të Kompanisë.

Neni 22

Interpretimi

Sipas kërkesës së Sekretarit/es së Kompanisë, Interpretimin e kësaj Rregullore e bënë Zyra Administrative e Kompanisë në bashkëpunim me Sekretarin/en e Kompanisë.

Neni 23

Ndryshimi

Ndryshimi i së njëjtës bëhet sipas procedurave të parapara me ligjet në fuqi.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 (tetë) ditë pas aprovimit të së njëjtës nga Bordi i Drejtorëve të K.R.U “ Hidroregjioni Jugor” SH. A. – Prizren.

Datë : 27.07.2012
Prizren

K.R.U. “ Hidroregjioni Jugor” SH. A. – Prizren
Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Dr.sc. Naser Bajraktari